



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil në Kosovë,

Në mbështetje të nenit 21.2 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Kosovës , Viti III, Nr. 28, më 4 qershor 2008),

Për qëllim të implementimit të Aneksit 10, Vëllimi I-II-II-IV të ICAO, Aneksi 14 Vëllimi I të ICAO, Dok 8168 të ICAO, Vëllimi II dhe ICAO Dok 8071, për kalibrimin e instalimeve aeronautike nga ajri,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 3/ 2011
PËR KALIBRIMIN E INSTALIMEVE AERONAUTIKE NGA AJRI

Neni 1
Zbatueshmëria

Kjo Rregullore përcakton kërkesat për kalibrimin e instalimeve aeronautike përbrenda territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Definicionet

AAC - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

Instalimet Aeronautike – një term që mbulon një numër të instalimeve teknike, qëllimi i të cilave është që të kontribuojnë në rrjedhën trafikut ajror, duke përfshirë komunikimin, navigacionin, pajisjet e radarëve dhe instalimet e ndriçimit në tokë si dhe procedurat relevante.

Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (OSHNA) – nënkupton secilin person që ka marrë lejen për të themeluar dhe operuar një aerodrom ose një zonë civile të një aerodromi ushtarak, ose ndonjë person që ka marrë një leje për të operuar një njësi të kontrollit të fluturimit e cila nuk është e bashkangjitur me një aerodrom të veçantë.

Kalibrime të Mandatuara– nënkupton kalibrimin, në lidhje me ngritjen në një kategori më të lartë (ILS) dhe/ose në lidhje me ndryshimet madhore të instalimeve ekzistuese ose instalimeve të reja.

Organizata për Kalibrim nga Ajri (FCO) – nënkupton një organizatë të miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës për të kryer kalibrimet nga ajri me aeroplan, të atyre instalimeve aeronautike ku kalibrimet e tilla nga ajri kërkohen në pajtim me këtë Rregullore.

NOTAM (Njoftim për pilotë) – nënkupton një njoftim të shpërndarë përmes mjeteve të telekomunikimit për vendosjen, statusin ose ndryshimin e instalimeve aeronautike, shërbimeve, procedurave ose aktiviteteve të rrezikshme; njohuri e cila është e rëndësishme thelbësore për kryerjen e fluturimit në mënyrë të sigurt.

Kalibrimi Rutinor – nënkupton kalibrimin e instalimeve dhe procedurave relevante në baza rutinore sipas afateve dhe intervaleve kohore të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Të përgjithshme

3.1 OSHNA duhet të sigurojë që kalibrimi është kryer vetëm nga FCO-të paraprakisht të miratuara nga AAC-ja. Instalimet dhe procedurat e ndërlidhura të cekura në nenin 4 duhet të kalibrohen përbrenda afateve të caktuara kohore dhe në intervalet kohore të cekura në nenin 5 dhe shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

3.2 OSHNA duhet të ndërpresë funksionimin e një instalimi:

- a. nëse kalibrimi ose çkado tjetër tregojnë se instalimi nuk i përmbush kërkesat e ICAO-s,
- b. nëse kalibrimi rutinor nuk është kryer përbrenda afateve kohore të caktuara në nenin 5 dhe shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje,
- c. në rastet e përcaktuara në udhëzimin operacional dhe të mirëmbajtjes për instalimin përkatës, dhe
- d. nëse kalibrimi është kryer nga një FCO e cila nuk është miratuar nga AAC-ja.

3.3 Çfarëdo ndryshimi në kryerjen e kalibrimit, për secilin rast individual, duhet të aprovohet nga AAC-ja.

3.4 OSHNA duhet të sigurojë që të gjitha aktivitetet, duke përfshirë edhe punët e mirëmbajtjes, zgjerimit dhe aktivitetet e reja përbrenda zonës së aerodromit dhe në afërsi të tij, janë të koordinuara në atë mënyrë që të shmanget ndikimi i paqëllimshëm i sinjaleve që transmetohen nga instalimet aeronautike.

Neni 4

Kalibrimet e mandatuara

Kalibrimet e mandatuara duhet të kryhen për instalimet vijuese, me procedurat e ndërlidhura, para se të futen në operim:

- a. Stacionet për gjetjen e drejtimit (VDF).
- b. Instalimet e komunikimit (COM) në lidhje me zonën e mbulueshmërisë.
- c. Sistemi për aterrim me instrumente (ILS), përfshirë sinjalin shënjuës (MM/OM) ose DME.
- d. Lokalizuesi (LLZ) i vetëm, përfshirë sinjalet shenjuese (MM/OM) ose DME.
- e. Drejtimi Omni-direkional VHF (VOR).
- f. Radiosinjali jo-direkional (NDB dhe L).
- g. Pajisja për Matjen e Distancës (DME).
- h. Radiosinjali shenjues (MKR).
- i. Radari në lidhje me zonën e mbulueshmërisë dhe hartat.
- j. Ndhimat vizuale në tokë për aterrim (APAPI/PAPI/PLASI).
- k. Sistemet e ndriçimit për afrim (*approach*).
- l. Procedurat për fluturim vizual.
- m. Procedurat për fluturim me ndihmën e instrumenteve.

Neni 5

Kalibrimet rutinore

5.1 Përveç kalibrimit të mandatuar, instalimet dhe procedurat relevante të instalimeve të cituara në nenin 4 më pas duhet të kalibrohen në baza rutinore në pajtim me afatet dhe intervalet kohore të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

5.2 Tolerancat e përcaktuara në shtojcën 1 mund të shfrytëzohen, por të mos tejkalohen.

5.2.1 Megjithatë, AAC-ja në raste të veçanta dhe pas kërkesës së arsyetuar, mund të miratojë një tejkalim të tolerancës.

5.3 Nëse një kalibrim zgjat më tepër se një ditë, koha për kalibrimin e ardhshëm duhet të llogaritet nga dita kur është inicuar kalibrimi.

Neni 6

Studimi i lokacionit

OSHNA mund të kërkojë kalibrimin për të vlerësuar një zonë/hapësirë për përshtatshmërinë në lidhje me një instalim të caktuar aeronautik.

Neni 7

Kalibrimet plotësuese

7.1 AAC mundet, në çdo kohë, të kërkojë që të kryhet një kalibrim plotësues, ose OSHNA mund të kërkojë një kalibrim të tillë.

7.2 Arsyet për kryerjen e një kalibrimi plotësues mund të jenë:

- a) Me rastin e pranimin të një raporti për gabime nga përdoruesit operativë ose nga organizata përgjegjëse teknike,
- b) Vërejtja e një devijimi të pazakontë nga kursi dhe/ose strukturës së kursit. Devijimi nuk duhet të jetë jashtë tolerancës me rastin e kalibrimit plotësues,
- c) Ndryshimet në rrethinë përbrenda zonave kritike dhe të ndjeshme,
- d) Vërejtja e shenjave të jostabilitetit nga të dhënat operacionale/ose vlerat e matura të regjistruara,
- e) Nëse është vërejtur se operimi dhe mirëmbajtja e instalimeve nuk është kryer në pajtim me udhëzimet e aprovuara.

7.3 Nëse kalibrimi plotësues është kërkuar nga OSHNA në bazë të cilësdo nga arsyetimet e përcaktuara në paragrafin 2, kjo e fundit duhet ta njoftojë AAC-në pa asnjë vonesë.

Neni 8

Kryerja e kalibrimit

8.1 OSHNA duhet të sigurojë që instalimet e nevojshme janë në dispozicion në lokacionet përkatëse. OSHNA duhet më tej të sigurojë përcaktimin e pozicioneve në WGS84, për pozicionet teodolit, nëse është relevante.

8.2 OSHNA duhet të ketë në dispozicion ekspertë teknikë në lidhje me përgatitjen dhe kompletimin e kalibrimit.

8.3 OSHNA duhet të sigurojë që informatat teknike për sistemet që duhet të kalibrohen u janë dorëzuar organizatave për kalibrim nga ajri.

8.4 OSHNA duhet të sigurojë koordinim të nevojshëm ndërmjet njësive të shërbimeve relevante të trafikut ajror dhe organizatave teknike në lidhje me realizimin e kalibrimit.

8.5 OSHNA duhet të ruajë dokumentacionin e kalibrimit për pesë (5) vite. Dokumentacioni për kalibrime të mandatuara, të përcaktuara në nenin 4 duhet, megjithatë, të mbahen derisa instalimi është operacional.

8.6 Menjëherë pas përfundimit të kalibrimit, por përbrenda afatit të caktuar në nenin 5 dhe shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje, FCO duhet të dorëzojë raportin preliminar në OSHNA. Raporti preliminar duhet të përmbajë një rekomandim që tregon nëse instalimi duhet të vazhdojë së operuari apo duhet të largohet nga operimi.

8.7 Nëse, në bazë të raportit të kalibrimit preliminar, OSHNA vendos që ta nxjerrë instalimin jashtë funksionit, ata menjëherë duhet të lëshojnë një NOTAM për këtë.

8.7.1 Instalimi nuk mund të rikthehet në operim përderisa një kalibrim i sërishëm të mos jetë përfunduar duke dhënë rezultate të kënaqshme.

8.7.2 OSHNA duhet të lajmërojë AAC-në menjëherë në lidhje me vendimin për ndalimin e ndonjë prej instalimeve të saja për shkak të rezultateve jo të kënaqshme të kalibrimit.

8.7.3 OSHNA duhet të dorëzojë një kopje të vlerave të matura të kalibrimit, duke përfshirë një kopje të raportit preliminar të FCO-së, në AAC, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të kalibrimit.

Neni 9 **Dispozitat ndëshkimore**

10.1 Shkelja e kërkesave të përcaktuara në nenin 3, 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet masave ndëshkimore administrative në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

10.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shkelja e dispozitave të nenit 3 dhe 7 të kësaj Rregulloreje mund të çojë deri në përgjegjësi penale në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 24 Maj 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm

Shtojca 1

Sistemet	Llojet e Pajisjeve	Kalibrime të Mandatuara	Afati i caktuar kohor dhe toleranca për kalibrim, referenca në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
COM	Stacionet për gjetjen e drejtimit (VDF)	Po	Çdo vit (+30 ditë)
	Instalimet e Komunikimit (COM-IC)	Po	
NAV	ILS, përfshirë edhe sinjalin shënjes	Po	180 ditë (+30 ditë)
	LLZ i vetëm, përfshirë sinjalin shënjes	Po	180 ditë (+30 ditë)
	VHF Omnidirectional Range (VOR)	Po	Në vit (+30 ditë)
	Non-directional Beacon (NDB)	Po	
	Pajisja për matjen e distancës (DME-PMD)	Po	Varësisht nga sistemi për të cilin DME është i kolokuar, përndryshe minimumi, për çdo vit
	Marker Radio Beacon (MKR)	Po	Varësisht nga sistemi për të cilin MKR është i kolokuar, përndryshe minimumi, për çdo vit
RADARI	Mbulueshmëria	Po	
	Hartat	Po	Në lidhje me ndryshimet madhore të planifikimit
AGA	APAPI/PAPI/PLASI	Po	180 ditë (+30 ditë)
	Sistemi i ndriçimit për afrim/ <i>approach</i>	Po	
PANS-OPS	Procedurat për fluturim vizual	Po	
	Procedurat për fluturim me ndihmën e instrumenteve	Po	